



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit**

**RELACION**

Data	
Nr. Prot	

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR  
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. FERDINAND SHEFQET SARAÇI, KANDIDAT PËR KRYETAR  
BASHKIE NË BASHKINË RROGOZHINË, QARKU TIRANË PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE  
TË DATËS 6 MARS 2022, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE"**

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati për Kryetar Bashkie".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për kryetar në bashkinë Rrogozhinë qarku Tiranë, më datë 08.02.2022, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 10 unik. KQZ bëri verifikimin "prima facie" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.615 prot, datë 08.02 2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1491/1, prot, datë 10.02.2022, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.616 prot, datë 08.02.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes

Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1360/1, prot, datë 22.02.2022, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, rezulton të ketë ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Fredri” në “Ferdinand”, sipas rregjistrimit themeltar të rregjistrimit të popullsisë së vitit 1974, “Gosë e Madhe” me referencë 1/31. Nuk ka informacion /dokumentacion në lidhje me ndryshimin.

## II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ferdinand Shefqet Saraçi. rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitetet të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga “Fredri” në “Ferdinand”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është dënuar nga Gjykata CHIETI ITALI, për veprën penale “Armbajtje pa leje në banesë”, për të cilën është vendosur masa e dënimit me burgim 4 muaj dhe me gjobë 100 000 lira, parashikuar nga neni 110 c.p dhe neni 10, Ligji 14.10.79, nr 497 të Ligjit Italian. Vendimi me marrëveshje e datës 18.01.1999, marrë formë të prerë me datë 16.03.1999.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.733. prot., datë 11.2.2022, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 196/70 prot., datë 21.12.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ferdinand

Shefqet Saraçi, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, të emrit nga “Fredri” në “Ferdinand” përbërës sipas së cilit rezulton aktualisht. Për këtë ndryshim nuk rezultojnë shënime përkatëse, për numrin dhe datën e aktit mbi bazën e të cilit ky ndryshim është kryer;
- Rezulton të jetë dënuar me 4 muaj burgim dhe 100 000 Lireta (baraz me 51,65 Euro) gjobë, i pezulluar me kusht dënimi me burgim për pesë vjet, me vendimin e marrëveshje nr.18/99, datë 18.1.1999, marr formë të prerë më datë 16.3.1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë së Chietit në Itali, për kryerjen e veprave penale:
  - Mbajtje pa leje e armëve (të zakonshme) dhe municioneve në bashkëpunim parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal (italian) dhe nenet 10,12 e 14 të ligjit nr.497 datë 14.10.1974;
  - Blerje,pranim ose fshehja e sendeve me origjinë të paligjshme për përfitimin e tij ose të të tjerëve, në bashkëpunim parashikuar nga nenet 110 e 648, të Kodit Penal (italian);
  - Mbajtje pa leje e armëve të gjahut dhe municioneve , në bashkëpunim parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal (italian), dhe nenet 10 e 14 të ligjit nr.497 datë 14/10.1974.  
Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri, parashikohen aktualisht në nenin 278, paragrafët 1 e 3, neni 280, nenin 287/b dhe nenin 25 të Kodit Penal.
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë në hetim , nga Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Chietit (Kieti) në Itali, për veprat penale;
  - Mbajtje pa leje të armës së zakonshme dhe municioneve në bashkëpunim , në bazë të nenit 110 të Kodit Penal (italian), si dhe neneve 10, 12 e 14 të ligjit nr.497 datë 14/10/1974;
  - Blerje pranim ose fshehje e sendeve me origjinë të paligjshme për përfitimin e tij ose të të tjerëve në bashkëpunim në bazë të 110 e 648 të Kodit Penal (italian);
  - Mbajtje pa leje të armës së gjahut dhe municioneve në bashkëpunim , në bazë të nenit 110 të Kodit Penal (italian), dhe neneve 10 e 14 të ligjit nr.497 datë 14.10.1974,

për të cilat është shpallur fajtor dhe dënua me 4 muaj burgim dhe 100 00 Lireta gjobë, i pezulluar me kusht dënimi me burgim për pesë vjet, me vendimin me marrëveshje nr.18/99, datë 18.01.1999, të marrë formë të prerë më datë 16.3.1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Chietit në Itali.

- Nuk rezulton të jetë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi:
  - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
  - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
  - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Përdorimin e të dhënave personale /gjeneraliteteve të tjera.

### III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, nuk ka marrë mandat, dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”

vlërësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

**Majlinda ÇELMETA** - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2024

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR  
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. FERDINAND SHEFQET SARAÇI, KANDIDAT PËR KRYETAR  
BASHKIE NË BASHKINË RROGOZHINË, QARKU TIRANË PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE  
TË DATËS 6 MARS 2022, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE"**

Sot më datë. 2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë qarku Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**Palë të interesuara:** Z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë qarku Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022.

**Baza ligjore:** Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Data: 2023 Nr:  
Ora:



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

## VËREJ:

### I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati për Kryetar Bashkie".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për kryetar në bashkinë Rrogzhinë qarku Tiranë, më datë 08.02.2022, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 10 unik. KQZ bëri verifikimin "prima facie" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.615 prot, datë 08.02 2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1491/1, prot, datë 10. 02.2022, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.616 prot, datë 08.02.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1360/1, prot, datë 22.02.2022, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, rezulton të ketë ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga "Fredri" në "Ferdinand", sipas rregjistrimit themeltar të rregjistrimit të popullsisë së vitit 1974," Gosë e Madhe" me referencë 1/31. Nuk ka informacion /dokumentacion në lidhje me ndryshimin.

### II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ferdinand Shefqet Saraçi. rezulton se ka deklaruar:

Data: 2023 Nr:  
Ora:



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar në Bashkinë Rrogzhinë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga “Fredri” në “Ferdinand”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Është dënuar nga Gjykata CHIETI ITALI, për veprën penale “Armbajtje pa leje në banesë”, për të cilën është vendosur masa e dënimit me burgim 4 muaj dhe me gjobë 100 000 lira, parashikuar nga neni 110 c.p dhe neni 10, Ligji 14.10.79, nr 497 të Ligjit Italian. Vendimi me marrëveshje e datës 18.01.1999, marrë formë të prerë me datë 16.03.1999.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.733. prot., datë 11.2.2022, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 196/70 prot., datë 21.12.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ferdinand Shefqet Saraçi, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, të emrit nga “Fredri” në “Ferdinand” përbërës sipas së cilit rezulton aktualisht. Për këtë ndryshim nuk rezultojnë shënime përkatëse, për numrin dhe datën e aktit mbi bazën e të cilit ky ndryshim është kryer;
- Rezulton të jetë dënuar me 4 muaj burgim dhe 100 000 Lireta (baraz me 51,65 Euro) gjobë, i pezulluar me kusht dënimi me burgim për pesë vjet, me vendimin e marrëveshje nr.18/99, datë 18.1.1999, marr formë të prerë më datë 16.3.1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë së Chietit në Itali, për kryerjen e veprave penale:



- Mbajtje pa leje e armëve (të zakonshme) dhe municioneve në bashkëpunim parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal (italian) dhe nenet 10,12 e 14 të ligjit nr.497 datë 14.10.1974;
- Blerje,pranim ose fshehja e sendeve me origjinë të paligjshme për përfitimin e tij ose të të tjerëve, në bashkëpunim parashikuar nga nenet 110 e 648, të Kodit Penal (italian);
- Mbajtje pa leje e armëve të gjahut dhe municioneve , në bashkëpunim parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal (italian), dhe nenet 10 e 14 të ligjit nr.497 datë 14/10.1974.  
Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri, parashikohen aktualisht në nenin 278, paragrafët 1 e 3, neni 280, nenin 287/b dhe nenin 25 të Kodit Penal.
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjydhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë në hetim , nga Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Chietit (Kieti) në Itali, për veprat penale;
  - Mbajtje pa leje të armës së zakonshme dhe municioneve në bashkëpunim , në bazë të nenit 110 të Kodit Penal (italian), si dhe neneve 10, 12 e 14 të ligjit nr.497 datë 14/10/1974;
  - Blerje pranim ose fshehje e sendeve me origjinë të paligjshme për përfitimin e tij ose të të tjerëve në bashkëpunim në bazë të 110 e 648 të Kodit Penal (italian);
  - Mbajtje pa leje të armës së gjahut dhe municioneve në bashkëpunim , në bazë të nenit 110 të Kodit Penal (italian), dhe neneve 10 e 14 të ligjit nr.497 datë 14.10.1974, për të cilat është shpallur fajtor dhe dënuar me 4 muaj burgim dhe 100 00 Lireta gjobë, i pezulluar me kusht dënimi me burgim për pesë vjet, me vendimin me marrëveshje nr.18/99, datë 18.01.1999, të marrë formë të prerë më datë 16.3.1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Chietit në Itali.
- Nuk rezulton të jetë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi:
  - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
  - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
  - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Përdorimin e të dhënave personale /gjeneraliteteve të tjera.

### III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealogjet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Rrogozhinë qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, nuk ka marrë mandat, dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objektin dhe qëllimin e procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

#### **V E N D O S:**

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Rrogozhinë, Qarku Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 2023 Nr:  
Ora:



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 2023 Nr:  
Ora:



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”